

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIV, nr. 7815
E enjte, 20 qershor 2024
Çmimi 0.50 €

Bregu: Zero roaming me BE-në deri më 2027

FAQE 8



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

BEGAJ: SHQIPËRIA ËSHTË AVOKATJA MË E MIRË E KOSOVËS NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

FAQE 4-5



Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, në një intervistë për "DW", ka thënë se Shqipëria është avokatja më e mirë e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe në çdo organizatë

ndërkombëtare dhe çdo iniciativë rajonale përmendet dhe mbrohet Kosova. Ai ka theksuar se ka përgjegjësi kushtetuese t'i mbrojë shqiptarët kudo ku ata punojnë e jetojnë dhe një

prej tyre është komuniteti shqiptar që jeton në Luginën e Prëshevës. Presidenti Begaj ka pohuar se imazhi i Shqipërisë në Evropë është përmirësuar goxha në vitet e fundit

AKTUALE



BIDENI LEHTËSON RRUGËN PËR SHTETËSI PËR GATI 500 000 BASHKËSHORTË TË AMERIKANËVE F. 2

NË QYTETIN E PODUJEVËS NJË RRUGË EMËRTOHET ME EMRIN E DORIS PACKUT F. 7

VEPRIMTARI SALI BISLIMI TAKON SENATORIN E DHOMËS SË LARTË FEDERATIVE TË BERNIT, WERNER SALZMANN F. 3

EKONOMI



FORUMI I PARË I BIZNESIT KOSOVË - PORTUGALI, GËRVALLA FTON BIZNESET PORTUGJEZE TË INVESTOJNË NË KOSOVË F. 8

KURTI VIZITON PORTIN E HAMBURGUT, SHEH SISTEMIN E SKANIMIT TË NGARKESAVE ME RREZE X F. 8

SPORT



SHQIPËRIA SHIJON PIKËN E PARË NË KAMPIONATIN EVROPIAN F. 10

LAJÇAKU NË PRISHTINË: TË PËRSHPEJTOHET ZBATIMI I MARRËVESHJES PËR NORMALIZIM MARRËDHËNIESH F. 3



BORRELLI REKOMANDON HEQJEN E MASAVE TË BE-SË NDAJ KOSOVËS F. 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Bideni lehtëson rrugën për shtetësi për gati 500 000 bashkëshortë të amerikanëve

WASHINGTON, 19 QERSHOR - Presidenti amerikan Joe Biden ka paraqitur një prej përpjekjeve më të mëdha për t'ua lehtësuar rrugën drejt shtetësisë qindra mijëra migrantëve në Shtetet e Bashkuara që janë të martuar me shtetas amerikanë.

Ky vendim është në kundërshtim të plotë me planet e rivalit republikan Donald Trump për dëbime masive. "Ne mund ta rregullojmë këtë. Edhe këtë po e bëj sot", ka thënë Bideni prej Shtëpisë së Bardhë, duke iu referuar përpjekjeve për ta legalizuar qëndrimin e kësaj kategorie të migrantëve.

"Hapat që do të marr sot mbështeten në masë prej popullit amerikan".

Programi do të vlejë për gati 500 000 bashkëshortë që kanë jetuar në ShBA për të paktën 10 vjet, nisur prej 17 qershorit, është

thënë në deklaratat e lëshuara prej Shtëpisë së Bardhë dhe Departamentit Amerikan për Siguri Kombëtare.

Programi do të përfshijë edhe rreth 50 000 fëmijë nën moshën 21-vjeçare, që kanë një prind amerikan.

Bideni, demokrat që synon një mandat të dytë si president, i ka fituar zgjedhjet edhe me premtimin për të përmbytur shumë politika kufizuese për migrantët, të fuqizuara prej paraardhësit të tij, Trumpit, i cili, po ashtu, synon edhe një mandat në Shtëpi të Bardhë.

Mirëpo, i përballur me arrestime masive të migrantëve në kufirin ShBA - Meksikë, Bideni e ka ashpërsuar tonin ndaj migrantëve në muajt e fundit.

Më herët gjatë këtij muaji, Bideni ua ka ndaluar



migrantëve që kalojnë paligjshëm kufirin ShBA - Meksikë të kërkojnë azil politikë e ngjashme me atë të Trumpit, e cila është kritikuar prej disa demokratëve dhe organizatave që mbrojnë të drejtat e migrantëve.

Megjithatë programi për legalizim të bashkëshortëve të shtetasve amerikanë mund ta forcojë mesazhin e tij se mbështet një sistem më njerëzor të migrimit dhe që dallon prej Trumpit.

Në ShBA veçse ekziston një

mënyrë që migrantët e martuar me amerikanë të sigurojnë leje të qëndrimit. Mirëpo në shumicën e rasteve, ata që kanë hyrë ilegalisht në ShBA, fillimisht duhet të kthehen mbrapsht në vendlindjet e tyre për disa vjet, para se t'u mundësohet kthimi në mënyrë të ligjshme.

Program i ri do t'u mundësojë tani atyre që të aplikojnë për leje të qëndrimit pa u larguar prej ShBA-së dhe nëse sigurojnë lejen për qëndrim, ata kanë mundësi të aplikojnë edhe për shtetësi.

Personat që konsiderohet se përbëjnë kërcënim për sigurinë publike apo kanë histori të problemeve nuk do të mund të aplikojnë.

Zbatimi i programit do të nisë në muajt e fundit dhe besohet se meksikanët do të përfitojnë më së shumti prej tij.

Fundoset një anije që u sulmua nga rebelët Huthi në Detin e Kuq

Londër, 19 qershor - Një anije transportuese u fundos në Detin e Kuq pas një sulmi nga rebelët jemenas Huthi që besohet se vranë një marinar në bord, thanë autoritetet më 19 qershor. Kjo është anija e dytë që është fundosur që kur rebelët nisën fushatën e sulmeve të tyre fundin e vitit të kaluar.

Fundosja e anijes Tutor në Detin e Kuq shënon atë që duket se është përshkallëzimi i ri nga rebelët, që mbështeten nga Irani, në fushatën e tyre për t'i shënjestruar anijet që kalojnë përmes korridorit të rëndësishëm detar.

Rebelët Huthi nisën sulmet e tyre në nëntorin e vitit të kaluar



për shkak të luftës në mes të Izraelit dhe Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga

Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - në Rripin e Gazës.

Sulmi ndaj kësaj anijeje vjen

pavarësisht një fushate në rajon të udhëhequr nga ShBA-ja, kur janë zhvilluar luftimet më intensive detare që nga Lufta e Dytë Botërore, teksa rebelët kryejnë sulme pothuajse çdo ditë ndaj anijeve komerciale dhe luftanijeve.

Anija Tutor, e regjistruar në Liberi, por në pronësi greke, u fundos në Detin e Kuq, tha Marina e Mbretërisë së Bashkuar, teksa lëshoi një paralajmërim për marinarët në rajon. "Autoritetet ushtarake raportojnë se janë parë fragmente të anijes në vendin ku së fundi është raportuar se gjendet ajo. Anija besohet se është fundosur", tha Mbretëria e Bashkuar.

Rebelët Huthi ende nuk kanë konfirmuar fundosjen e anijes, ndërkaq ushtria amerikane nuk ka komentuar për këtë rast.

Anija Tutor u sulmua rreth një javë më parë nga dronët e rebelëve Huthi. Të hënën, këshilltari për siguri kombëtare i Shtëpisë së Bardhë, John Kibry, tha se gjatë sulmit është vranë "një anëtar i ekuipazhit nga Filipinet".

Rebelët Huthi kanë kryer më shumë se 50 sulme ndaj anijeve, duke vranë katër marinarë. Ata kanë kapur një anije dhe që nga nëntori kanë fundosur dy të tjera. Ndërkaq, fushata ajrore, që udhëhiqet nga ShBA-ja kundër rebelëve jemenas, ka nisur në janar të këtij viti.

Izraeli "mund t'i ketë shkelur ligjet e luftës" gjatë fushatës ushtarake në Gazë

JERUSALEM, 19 QERSHOR - Forcat izraelite në mënyrë të përsëritur mund t'i kenë shkelur ligjet e luftës dhe kanë dështuar ta bëjnë dallimin mes civilëve dhe luftëtarëve gjatë fushatës së tyre ushtarake në Rripin e Gazës, tha Zyra për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara.

Në një raport, që ka analizuar gjashtë sulme izraelite që kanë shkaktuar numër të lartë të viktimave dhe shkatërrim të infrastrukturës civile, Zyra për të Drejtat e Njeriut tha se forcat izraelite "mund të kenë shkelur në mënyrë sistematike parimet e

dallimit, proporcionalitetit dhe masave parandaluese në sulm". "Kërkesa për t'i zgjedhur mjetet dhe metodat e luftës që shmangin ose të paktën minimizojnë në çdo masë dëmin e civilëve duket se në mënyrë të vazhdueshme është shkelur gjatë fushatës bombarduese të Izraelit", tha Komisionari i Lartë i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, Volker Turk. Ofensiva ajrore dhe tokësore e Izraelit ka vranë më shumë se 37 000 persona në Gazë, sipas autoriteteve shëndetësore në këtë enklavë.

Izraeli nisi fushatën e tij ushtarake pasi luftëtarët e Hamasit - grupit palestinez të shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - sulmuan jugun e Izraelit më 7 tetor duke vranë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer afër 250 të tjerë. Javën e kaluar Zyra për të Drejtat e Njeriut e OKB-së tha se vrasja e civilëve gjatë operacionit izraelit për t'i liruar katër pengje mund të përbëjë krim lufte, po ashtu krim lufte mund të jetë edhe mbajtja e civilëve nga Hamasi në zona të populluara.



Veprimtari Sali Bislimi takon senatorin e Dhomës së Lartë Federative të Bernit, Werner Salzmann

“Mbështes përpjekjet e juaja pa rezervë për drejtësi të paanshme të presidentit Thaçi në Gjykatën e Hagës”, i thotë Salzmann, Bislimit

BERN, 19 QERSHOR - Veprimtari dhe drejtori i OJQ “Zëri Perëndimor i Kosovës”, Sali Bislimi, është ftuar në drekë nga senatori i dhomës së lartë Federative nga kantoni Bern i partisë SVP/UDC, koloneli i ushtrisë, Werner Salzmann, më i votuari në zgjedhjet e fundit. Bislimi ka shkruar në “Facebook” për këtë takim, duke theksuar se ka marrë mbështetje për drejtësi të paanshme të ish-presidentit Thaçi në Gjykatën e Hagës. “Mbështes përpjekjet e juaja pa rezervë për drejtësi të paanshme të presidentit Thaçi në Gjykatën e Hagës, edhe interpelancën e Reto Nause drejtuar qeverisë zvicerane. Një bashkëbisedim miqësor ku biseduam të gjitha çështjet politike në vend edhe për politikën e jashtme të Zvicrës në raport me Kosovën. Unë kam përjetuar tmerrin kur isha ushtar i

Jugosllavisë kriminale, kur vetëm pse një natë isha duke dëgjuar lajmet e radio Tiranës kapiteni i dehur serb me kërcënimi me vrasje dhe hedhje nga dritarja nëse edhe një herë me ndodh duke me sekuestruar edhe transistorin. Ne shqiptarët kemi synim bashkimin e kombit në demokracinë evropiane si e vetmja mundësi për t'i evituar padrejtësitë ndaj nesh. Patriotët e vendit tim serbo-sllavia i dërgonte në ujdhesën e Goli Otok jo për turizëm por për t'i mbyllur sepse atje kishte një burg fatkeq, e njëjta gjë tash po ndodh me të njëjtat politika anti-shqiptare kjo në detin e veriut në Hagë. Me miq bëhet madhështia! Rroftë Zvicra, vendi me një popull të bekuar dhe kombi shqiptar më i vuajtur në Evropë!”, ka shkruar Bislimi.



Lajçaku në Prishtinë: Të përrshpejtohet zbatimi i marrëveshjes për normalizim marrëdhëniesh

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim emisarin special të BE-së, Miroslav Lajçak. Gjatë takimit kanë biseduar mbi rrugën përpara në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit dhe Aneksit të Zbatimit të Ohrit. Zëvendëskryeministri Bislimi ritheksoi se Republika e Kosovës mbetet palë konstruktive në dialog, e përkushtuar për normalizimin e plotë të marrëdhëniesh dhe për njohjen reciproke. Ai nënvizoi rëndësinë e nënshkrimit si dhe zbatimit të marrëveshjeve përmes një plani të sekuencimit të balancuar, të barabartë dhe të drejtë për palët. Gjithashtu, shtoi se Serbia në vazhdimësi e ka shkëlur marrëveshjen në shumicën e neneve të saj, veçanërisht nenin 4 të saj kur ka votuar e lobuar kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare, po ashtu edhe përmes letrës së ish-kryeministres Brnabiq në dhjetorin e kaluar. I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se dy vendet duhet të bëjnë hapa për ta zbatuar Marrëveshjen për normalizim të marrëdhëniesh, të arritur në shkurt të vitit të kaluar. Lajçaku ka thënë se duhet të



hiqen masat ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës dhe që ura mbi lumin Ibër duhet të hapet në një mënyrë që nuk përrshkallëzon situatën. Ai i ka bërë këto deklarata pas një takimi që ka zhvilluar me zëvendëskryeministrin e Kosovës, Besnik Bislimi. “Ne kemi një marrëveshje. Duhet ta përrshpejtojmë zbatimin e saj. Kjo ka qenë tema e parë që kemi diskutuar me Bislimin, dhe pika e dytë për Planin e BE-së për Rritje Ekonomike”, ka theksuar Lajçak. Plani i BE-së parasheh ndarjen e një fondi prej gjashtë miliardë eurosh për vendet e Ballkanit Perëndimor për periudhën 2024-2027, për ta përrshpejtuar integrimin evropian të këtij rajoni. Lajçaku ka thënë se për të fituar

qasje në këto fonde, Kosova dhe Serbia e kanë parakusht angazhimin konstruktiv në dialogun e Brukselit, dhe si personi përgjegjës për ta bërë vlerësimin për përparimin në dialog, ai ka thënë se e ka parë të nevojshëm një takim me zyrtarët në Kosovë dhe Serbi për hapat që duhet të marrin palët. Pas vizitës në Kosovë, diplomati evropian do të takohet në pasditen e së mërkurës në Beograd me presidentin serb Aleksandar Vuçiq. Lajçaku do të duhej ta niste mandatin si ambasador në Zvicër prej 1 shtatorit të këtij viti, mirëpo ai ka thënë se i është kërkuar ta mbajë pozitën që ka deri në fund të janarit të vitit 2025, dhe ka thënë se deri atëherë ka shumë punë për të bërë.

Përgjatë konferencës për medie, Lajçaku është pyetur edhe për raportin që kryediplomati evropian Josep Borrell ua ka dorëzuar vendeve anëtare të BE-së, lidhur me masat që i janë vënë Kosovës më shumë se një vit më parë. Në raport është bërë vlerësimi nëse duhen hequr masat ndaj Kosovës, të vëna për shkak të tensionimit të situatës në veri të vendit, në maj dhe qershor të vitit 2023. Atëbotë BE-ja pati thënë se Kosova nuk ka bërë mjaftueshëm për shtensionim të situatës. Lajçaku e ka ripërsëritur qëndrimin e tij që masat ndaj Kosovës do të duhej të hiqeshin si shenjë solidariteti pas sulmit që ka ndodhur në Banjskë të Zveçanit, në shtator të vitit të kaluar, por që u takon vendeve të BE-së ta marrin atë vendim. Vendet e BE-së pritet të diskutojnë të mërkurën për raportin e Borrellit. Kosova e konsideron si terrorist sulmin vdekjeprurës të Banjskës dhe akuzon Serbinë për organizim dhe kryerje të tij, por Beogradi zyrtar mohon gjithçka. Përgjatë konferencës, Lajçaku është pyetur edhe nëse duhet të hapet ura kryesore mbi lumin Ibër. Lajçaku ka thënë çështja e urës është e zgjidhur me dy marrëveshje të arritura në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë. “Pozicioni i BE-së ka

qenë që ura duhet të hapet, mirëpo në një mënyrë që nuk përrshkallëzon situatën dhe në mënyrë ideale duhet të diskutohet me personat që prekin vendim”, ka thënë diplomati evropian, duke përmendur mundësinë që për këtë temë të diskutohet sërish në kuadër të dialogut. Vendimi për hapje të urës është marrë në prill të vitit 2023 në Kuvendin Komunal të Mitrovicës së Veriut, por nuk janë marrë asnjëherë hapa drejt zbatimit të tij. Aktualisht në krye të kësaj komune është Erden Atiq nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje. Ura mbi lumin Ibër ndan Mitrovicën në pjesën jugore, të banuar me shumicë shqiptare, dhe në pjesën veriore, të banuar me shumicë serbe, qysh prej vitit 1999. Në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi palët janë pajtuar që ura të hapet për qarkullim, por është hapur vetëm njëra anë e saj për këmbësorë. Kundër hapjes së urës ka dalë javë më parë Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Sipas saj, hapja e urës për automjete është “absolutisht e panevojshme, e papranueshme dhe një lëvizje përrshkallëzuese, që synon destabilizimin e mëtejshëm të situatës në terren”.



Begaj: Shqipëria është avokatja më e mirë e Kosovës në arenën ndërkombëtare

Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, në një intervistë për "DW", ka thënë se Shqipëria është avokatja më e mirë e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe në çdo organizatë ndërkombëtare dhe çdo iniciativë rajonale përmendet dhe mbrohet Kosova. Ai ka theksuar se ka përgjegjësi kushtetuese t'i mbrojnë shqiptarët kudo ku ata punojnë e jetojnë dhe një prej tyre është komuniteti shqiptar që jeton në Luginën e Preshevës. Presidenti Begaj ka pohuar se imazhi i Shqipërisë në Evropë është përmirësuar goxha në vitet e fundit

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, në një intervistë për DW, ka folur për sukseset e kombëtares, marrëdhëniet me Kosovën dhe Greqinë, shqiptarët në Luginën e Preshevës dhe diasporë. Ai ka theksuar se pritshmëritë e tij janë që procesi i zgjerimit të Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE do të jetë një proces strategjik për Evropën dhe jetik për Ballkanin Perëndimor. Begaj ka thënë se imazhi i Shqipërisë në Evropë është përmirësuar goxha në vitet e fundit. "Shqipëria është e pranishme në faqet e para të medieve botërore, për faktin që

turizmi në Shqipëri vitin e shkuar ishte një shifër rreth 10 milionë turistë, këtë vit mendohet dhe parashikohet të jenë rreth 15 milionë turistë", është shprehur Begaj. Duke folur për proceset në Kosovë, presidenti Begaj ka deklaruar se Kosova është interesi më madhor i Shqipërisë. "Shqipëria është avokatja më e mirë e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe në çdo organizatë ndërkombëtare dhe çdo iniciativë rajonale përmendet dhe mbrohet Kosova. Patjetër që ne do të kemi këtë bashkëpunim dhe në të ardhmen nuk mendoj që ka vend për pakënaqësi. Ne jemi

aty dhe do të jemi gjithmonë në mbështetje të Kosovës. Para dy ditësh isha në Kosovë. Mora pjesë në festimet e 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës. Kjo tregon që marrëdhëniet tona janë të shkëlqyera", ka thënë ai.

Z. President, kryefjala këto ditë në Gjermani është futbolli. Si e vlerësoni lojën e deritanishme të kombëtares shqiptare?

Bajram Begaj: Përhëndetje! Kënaqësi të jem në këtë intervistë me ju. Padyshim që kryefjala botërore tani është futbolli. Dhe për mua si president i Republikës së Shqipërisë është ekipi kombëtar i Shqipërisë. Jam shumë i kënaqur me ekipin kombëtar. U uroj shumë suksese dhe besoj se dhe Kampionati Evropian i Futbollit është fitore për tifozët shqiptarë, për tifozët kuqezi.

Çfarë roli mund të luajë kjo pjesëmarrje e Shqipërisë për përmirësimin e imazhit të Shqipërisë në Evropë?

Bajram Begaj: Unë mendoj që imazhi i Shqipërisë në Evropë është përmirësuar goxha në vitet e fundit. Shqipëria është e pranishme në faqet e para të

medieve botërore, për faktin që turizmi në Shqipëri vitin e shkuar ishte një shifër rreth 10 milionë turistë, e këtë vit mendohet dhe parashikohet të jenë rreth 15 milionë turistë. Kjo tregon që Shqipëria ka rol të rëndësishëm, sidomos zhvillimi i Shqipërisë, siguria dhe ajo çfarë bën në arenën ndërkombëtare është shumë e mirëpritur dhe e respektuar.

Ju do të takoheni edhe me presidentin e Gjermanisë, Frank-Walter Steinmeier. Cilat janë pritshmëritë tuaja për rolin e Gjermanisë ndaj Shqipërisë dhe rajonit?

Bajram Begaj: Patjetër është kënaqësi të mirëpritim nga presidenti i Gjermanisë. Është kënaqësi që do të vazhdoj bisedën miqësore të zhvilluar dy vjet më parë në Shqipëri në lidhje me bashkëpunimin bilateral midis Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë, në lidhje me procesin e integrimit në BE, po ashtu edhe për ngjarjet në rajon.

Ne patëm zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe kemi vënë re një shtyrje nga e

djathta. A keni frikë se kjo do ta ngadalësojë pak procesin e zgjerimit?

Bajram Begaj: Unë nuk kam asnjë frikë. Pritshmëritë tona janë që procesi i zgjerimit të Ballkanit Perëndimor drejt anëtarësimit në BE do të jetë një proces strategjik për Evropën dhe jetik për Ballkanin Perëndimor. Besoj shumë që ky proces të përshpejtohet. Ballkani Perëndimor ka nevojë për Evropën dhe besoj se Shqipëria është në avangardë të këtij procesi për faktin që është kampione e bashkëpunimit rajonal, ndikon shumë për miqësitë midis vendeve të Ballkanit Perëndimor, po ashtu edhe për paqen, sigurinë, stabilitetin, zhvillimin e qëndrueshëm dhe aspiratën dhe ëndrrën për t'u integruar në Bashkimin Evropian.

Ju e thatë vetë, ju jeni promotor i bashkëpunimit rajonal. Nga ana e Kosovës ka shpeshherë pakënaqësi. Ministrja e Jashtme thotë se politika e Shqipërisë ndaj Serbisë do të duhet të kalojë nëpërmjet Kosovës. Ju çfarë mendimi keni për këtë?

Bajram Begaj: Kosova është

Borrelli rekomandon heqjen e masave të BE-së ndaj Kosovës

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell, u ka rekomanduar shteteve anëtare që të marrin qëndrim për heqjen e masave ndaj Kosovës, mëson Radio Evropa e Lirë nga burimet diplomatike në bllok, që kanë pasur qasje në raportin e shefit të diplomacisë së BE-së.

Burimet cituan rekomandimin e bërë nga Borrelli në raportin e tij ku thuhet se: "Duke marrë parasysh hapat që ka ndërmarrë Kosova drejt përbushjes së kërkesave të BE-së të shprehura në deklaratën e 3 qershorit të vitit 2023, përfaqësuesi i lartë i rekomandon Këshillit që ta marrë qëndrimin e heqjes së

masave ndaj Kosovës, në të njëjtën kohë duke respektuar prerogativat institucionale".

Në rekomandimin e tij, Borrelli ka shkruar se "vendimi nga ana e Këshillit do të ishte sinjal politik dhe do të kontribuonte në kontekstin e balancuar në të cilin dialogu Prishtinë - Beograd, që lehtësohet nga BE-ja, mund të ecë përpara.

Nga Kosova pritet që ta shfrytëzojë këtë mundësi për të vepruar në mënyrë të uljes së tensioneve që t'i evitohet veprimet e pakoordinuara, thuhet në raportin e Borrellit, sipas burimeve diplomatike në BE.

Në këtë raport Borrelli ka përmendur në mënyrë specifike kërkesat që i ishin bërë Kosovës

vitin e kaluar, të cilat lidhen me veprimet e njëjësive speciale të Policisë së Kosovës në pjesën veriore të shtetit - të banuar me shumicë serbe - si dhe me ushtrimin e funksioneve nga ana e kryetarëve shqiptarë të katër komunave në veri.

Në raport, Borrelli ka shkruar se BE-ja do të vazhdojë t'i ndjekë nga afër zhvillimet në veri të Kosovës si dhe veprimet e Kosovës dhe Serbisë, të cilat, sipas tij, nuk duhet të krijojnë tensione të reja.

Për raportin e Borrellit pritet të diskutohet në takimin e 19 qershorit të Komitetit politik dhe të sigurisë së BE-së (PSC). Në bazë të diskutimeve do të shihet pastaj se a do të vendoset për

heqjen e masave të vendosura ndaj Kosovës. Sipas burimeve diplomatike në Bruksel, heqja e masave ndaj Kosovës mund të jetë në rend dite edhe në takimin e Këshillit për Punë të Jashtme që zhvillohet në nivel ministrash më 24 qershor.

Borrelli ua dorëzoi raportin e tij shteteve anëtare më 18 qershor. Zyrtarë të BE-së kishin diskutuar për herë të parë rreth mundësisë së heqjes së masave në prill të këtij viti, andaj edhe kanë kërkuar një raport prej Borrellit.

Raporti i Borrellit ishte planifikuar të dorëzohet më herët, sepse vendet e BE-së kishin kërkuar që kjo të bëhet "sa më parë që të jetë e mundur", por ishte shtyrë për shkak të

veprimeve të autoriteteve të Kosovës për mbylljen e objekteve të Bankës Kursimore postare të Serbisë në pjesën veriore të Kosovës.

Masat ndaj Kosovës ishin vendosur para një viti si përgjigje ndaj përshkallëzimit të situatës së sigurisë në veri të Kosovës, kur kryetarët shqiptarë - të dalë nga zgjedhjet që u bojkotuan nga serbët lokalë - nisën detyrën e tyre në komunat në veri.

Ndër masat e BE-së janë suspendimi i përkohshëm i punës së trupave të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Kosova, po ashtu, nuk ftohet në ngjarjet e nivelit të lartë dhe vizitat bilaterale janë suspenduar, përveç atyre që fokusohen në adresimin e krizës në veri të Kosovës në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja.

Masat e tjera janë suspendimi i programit të fondeve për Kosovën në kuadër të IPA 2024 (Fondet e Para-Anëtarësimit).

Propozimet e dorëzuara nga Kosova në kuadër të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) nuk janë paraqitur për shqyrtim në bordin e këtij fondi. Kontratat e reja, ku autoritetet e Kosovës janë përfutuese tash për tash, janë të ndalura.

Qeveria e Kosovës ka insistuar disa herë se ajo i ka përbushur kërkesat dhe se situata në veri të Kosovës është shtensionuar, serbët e Kosovës kanë pasur mundësi të votojnë për shkarkimin e kryetarëve të komunave dhe tash, sipas tyre, nuk ka më arsye që të mbahen këto masa.



interesi më madhor i Shqipërisë, Shqipëria është avokatja më e mirë e Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe në çdo organizatë ndërkombëtare dhe çdo iniciativë rajonale përmendet dhe mbrohet Kosova. Patjetër që ne do të kemi këtë bashkëpunim dhe në të ardhmen nuk mendoj që ka vend për pakënaqësi. Ne jemi aty dhe do të jemi gjithmonë në mbështetje të Kosovës. Para dy ditësh isha në Kosovë. Mora pjesë në festimet e 25-vjetorit të çlirimit të Kosovës. Kjo tregon që marrëdhëniet tona janë të shkëlqyera.

Marrëdhënie shumë të mira kemi, thotë ministri i Jashtëm i Shqipërisë, edhe me Greqinë, por Greqia e ka bllokuar procesin e integritetit për shkak të çështjes Beleri. Si mund t'i tejkalohet Shqipëria këto sfida?

Bajram Begaj: Shqipëria i ka bërë më së miri detyrat e shtëpisë. Shqipëria ka kaluar

me sukses procesin e screening, ka hapur konferencën e parë ndërministrorë dhe pret për hapjen e kapitullit të parë që ka të bëjë me kapitullin themelor të legjislativës. Nuk besoj se çështjet bilaterale do të ndikojnë në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Ju jeni president i të gjithë shqiptarëve, edhe atyre që janë jashtë atdheut. Si i adresoni ju problemet e shqiptarëve në Serbi kur flisni me kolegët tuaj?

Bajram Begaj: Patjetër që e kam përgjegjësi kushtetuese t'i mbroj shqiptarët kudo ku ata punojnë e jetojnë dhe një prej tyre është komuniteti shqiptar që jeton në Luginën e Preshevës. Unë në fjalën time në asamblenë e përgjithshme të Kombeve të Bashkuara kam ngritur shqetësimin në lidhje me shpopullimin e rajonit të Luginës së Preshevës, me pasivizimin e adresave, dhe

besoj se është në nderin tonë që të vazhdojmë t'i mbrojmë interesat e shqiptarëve në këtë Luginë.

Ju u takuat me diasporën shqiptare. Një problem kryesor për diasporën është edhe mungesa e mundësisë për të votuar në vendet ku jeton. Si po angazhoheni ju për ta realizuar këtë?

Bajram Begaj: Unë kam bërë disa takime me diasporën shqiptare dhe sot bëra një takim për diasporën që jeton në Berlin. Patjetër që për mua diaspora është frymëzim. Është e nevojshme me ide të kontribuojë në atdhe. Dhe besoj se bota e diasporës do të adresohet dhe përfaqësimi politik i saj do të jetë i mirëpritur.

Një problem mbetet çështja e brendshme, panorama ndërpartiake në Shqipëri, marrëdhëniet pozitë-opozitë, të cilat ende nuk kanë arritur të

gjejnë një gjuhë të përbashkët për të bashkëpunuar në mënyrë konstruktive për vendin. Çfarë mund të bëni ju për të pajtuar më shumë?

Bajram Begaj: Në zbatim dhe në respekt të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë unë jam president i Shqipërisë dhe qëndroj mbi palët, nuk merrem me politikën e ditës. Kjo nuk do të thotë që unë nuk e ndjek, që nuk jam i vëmendshëm karshi politikës së ditës, por gjithsesi, në çdo mesazh timin, të cilin ma lejon Kushtetuta t'ia adresoj Kuvendit apo ta adresoj në takime të rëndësishme me ambasadorët e huaj apo në ngjarje të rëndësishme në vend, kam adresuar nevojën për të pasur një komunikim dhe dialog të qëndrueshëm midis opozitës dhe pozitës, sepse mendoj që vendi i duhur për t'i ballafaquar idetë është parlamenti. Është parlamenti ai që duhet t'i bëjë ligjet dhe t'i adresojë zgjidhjet në interes të qytetarëve, në interes publik,

në interes kombëtar, në interes të të gjithëve.

Në vjeshtë zhvillohet për herë të dhjetë procesi i Berlinit. Cilat janë pritshmëritë tuaja nga ky takim?

Bajram Begaj: Patjetër që unë e shikoj procesin e Berlinit si një proces që duhet ta përshpejtojë procesin e anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE. Vitin e shkuar patëm fatin ta organizojmë procesin e Berlinit me mjaft sukses dhe të gjitha ata elementë që lidhen me adresimin e çështjeve për t'u zgjidhur, gjatë këtij samiti do të adresohen për zgjidhje dhe do ta gjejmë vendin e merituar.

Çfarë parashikoni për ndeshjen Kroaci - Shqipëri?

Bajram Begaj: Nuk jam i mirë për parashikime, por shpresoj shumë që ekipi kombëtar shqiptar të fitojë dhe dua që të fitojë.

Besnik Tahiri: Rruga për Podujevë është bërë si në Kandahar

PODUJEVË, 19 QERSHOR - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka reaguar për gjendjen e rrugëve magjistrale në Podujevë, Gjakovë, Mitrovicë e Gjilan. Tahiri ka thënë se këto rrugë janë bërë të rrezikshme si në Kandahar. "Rruga për Podujevë është bërë si rrugë për Kandahar, e rrezikshme, e

dëmshme për njerëz e vetura dhe gati e patejkalueshme. Pothuajse në të njëjtën gjendje janë edhe rrugët për Gjakovë, Mitrovicë dhe Gjilan. Pra në të katër anët e Kosovës rrugët janë të bllokuara, ndërsa lavdet nuk ndalen", ka thënë Tahiri. Tahiri ka kërkuar që për këta pak muaj që i kanë mbetur

këtij pushteti, ta përfundojë ndonjë rrugë. "Mirë është që në këta muajt që i kanë mbetur kësaj qeverie të përfundojë ndonjë rrugë dhe të dalë me diçka konkrete në këtë 4-vjeçar. Përndryshe, po shihet që ky kabinet qeveritar është i pazot për të punuar diçka të hairit për vendin", ka thënë Tahiri.



Lladrovci: Leotrimi do të japë mesazh për dhimbjen e thellë për 1 432 fëmijët e vrarë në Kosovë



DRENAS, 19 QERSHOR - Me rastin e zbulimit të shtatores së Leotrim Ahmetit në Skenderaj, i vrarë nga forcat serbe më 1998, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, vendosi kurora me lule bashkë me nënën heroinë, Shukrie Ahmeti. "Në Ditën e Çlirimit të Skenderajt vendosa lule të freskëta me nënën heroinë Shukrie Ahmeti, pranë shtatores së Leotrim Ahmetit, i cili ndërroi jetë më 11 shtator 1998, në moshën shtatëvjeçare. Leotrimi ishte biri i dëshmorit të UÇK-së, Malush Ahmeti nga Rezalla heroike, i cili ra në altarën e lirisë më 15.5.1999", ka shkruar Lladrovci në "Facebook". Ai ka deklaruar se "kjo shtatore, ashtu sikur dialogu i fundit i

Leotrimit me nënën Shukrie, janë mesazhe të gjithmonshme që kurrë të mos harrohet sakrificat e popullit tonë liridashës, as veprat makabre të okupatorit serb. Është amanet për ta fuqizuar e ndërtuar shtetin i cili do të jetë në mbrojtje të lirisë e jetës së qytetarëve". "Leotrimi nga Skenderaj, do ta japë mesazh për dhimbjen e thellë për 1.432 fëmijët e vrarë në Kosovë gjatë luftës çlirimtare, do të jetë kujtesë për rrugën tonë deri te liria dhe vlera e çlirimit nga okupatori serb. Përjetësimi i Leotrimit në bronz, është vepër që do të jetojë në kujtesën e kombit më gjatë se secili nga ne", ka theksuar në fund kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci.

13-vjetori i vdekjes së Nekibe Kelmendit, në selinë e LDK-së shpaloset pllaka dhe portreti përkujtimor i saj

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Brenda hapësirave të selisë qendrore në LDK të mërkurën janë shpalosur pllaka dhe portreti përkujtimor i Nekibe Kelmendit në 13-vjetorin e vdekjes së saj. Në këtë ceremoni ka qenë e pranishme edhe vajza e saj, Kosovarja. Lideri i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se Kelmendi ishte një emblemë identifikuese e një gruaje, e një nëne të pamposhtur që, përkundër sfidave e dhimbjeve të rënda, nuk u gjunjëzua asnjëherë. "Portreti i saj, i vendosur tashmë përballë Enver Malokut, e në varg me të tjerë që do të pasojnë, do të shërbejnë si rikujtim i fuqishëm për secilin që kapërcen nëpër korridorin hyrës të kësaj shtëpie të demokracisë. Vepra e

madhe e lëvizjes kombëtare për liri, pavarësi e demokraci është bartur nga njerëz të mëdhenj me ëndrra e përkushtime të mëdha! Nekibe Kelmendi, atdhetarja dhe veprimtarja e madhe e kauzës nacionale, ishte një emblemë identifikuese e një gruaje, e një nëne të pamposhtur që, përkundër sfidave e dhimbjeve të rënda, nuk u gjunjëzua asnjëherë. Ajo ka gravuar emrin e saj të merituar jo vetëm si një nga aktivistet e para të LDK-së, por edhe si profil i një njeriu që shkriu veten për formimin dhe konsolidimin e shtetësisë së Kosovës. Gjurmët, sakrificat dhe puna e Nekibe Kelmendit tashmë janë udhërrëfyes për të gjithë ne që të ecim përpara", ka theksuar Abdixhiku.



Komuna e Prizrenit paralajmëron hapjen e Shtëpisë së Pleqve dhe rifunksionalizimin e ambulancës për pensionistët

PRIZREN, 19 QERSHOR - Nën kryetari i komunës së Prizrenit, Kujtim Gashi, ka pritur të mërkurën në takim kryetarin e Shoqatës së Pensionistëve të Prizrenit, Isuf Vraniqi, sekretarin Alajdin Haskuka dhe anëtarin

Kadri Skeja, me ç'rast i ka njoftuar për veprimet e komunës së Prizrenit në përputhje me nevojat e pensionistëve të qytetit, që përfshijnë hapjen e Shtëpisë së Pleqve, rifunksionalizimin e

ambulancës dedikuar pensionistëve për të siguruar qasje më të lehtë në shërbime shëndetësore dhe në sigurimin e barnave, që do t'i përmirësonte kushtet dhe kujdesin ndaj pensionistëve.

Gjithashtu, u diskutua për rifunksionalizimin e objektit për pensionistët në lagjen "Terzimahallë", që do të ofrojë shërbime dhe kujdes shtesë për pensionistët e kësaj zone të Prizrenit.





Në qytetin e Podujevës një rrugë emërtohet me emrin e Doris Packut

PODUJEVË, 19 QERSHOR - Nga sot një rrugë në qytetin e Podujevës do ta bartë emrin e mikes së madhe të shqiptarëve, ish-deputetes së Parlamentit Evropian, Doris Pack.

Në ceremoninë për vendosjen e emërimit të rrugës ishte kryetari i komunës, Shpejtim Bulliqi, nënkryetarja Marigona Lahu,

drejtorë dhe asamblistë komunalë si dhe qytetarë. Doris Pack ishte zë i fuqishëm i shqiptarëve në Parlamentin Evropian.

Në shënimin e 25-vjetorit të çlirimit të Podujevës, Doris Packu është nderuar edhe me dekoratën "Qytetare Nderi" e komunës së Podujevës.

Kurti për Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt: Angazhohemi për drejtësi

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Të mërkurën është shënuar Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt, ndërkaq kryeministri i vendit, Albin Kurti, theksoi se gjatë viteve 1998-'99 në Kosovë dhuna seksuale është përdorur si armë lufte nga Serbia.

Kurti ka shkruar në "Facebook" se ky është krim jo vetëm ndaj individit, por ndaj gjithë shoqërisë dhe ka lënë pasojë të thella dhe të gjëra. "Në Ditën ndërkombëtare për eliminimin e dhunës seksuale në konflikt, bëjmë thirrje për solidaritet nga familjet dhe shoqëria. Është detyrim yni i përbashkët t'i përkrahim të mbijetuarat. Të jemi zë i fuqishëm e krahi i fortë. Sot dhe përherë. Në kujtim të viktimave që kanë humbur jetën, përkulemi me respekt. Nderojmë të



mbijetuarat për forcën e qëndresës së tyre. Angazhohemi për mbështetje institucionale dhe për drejtësi. Përmes ndryshimit të ligjit e kemi zgjidhur afatin për aplikim për njohjen e statusit, viktimë e dhunës seksuale të luftës, deri më 15 maj 2025. Duke ua njohur vuajtjet grave dhe vajzave, burrave dhe djemve të mbijetuar, ne i inkurajojmë që të thyjnë heshtjen për këtë krim lufte", ka shkruar Kurti.

Draft-statuti i Asociacionit, Joseph tregon pikën e mospajtimit me Kurtin

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Profesori i Universitetit "Johns Hopkins" në Uashington, Edward P. Joseph, ka folur për insistimin e kryeministrit Albin Kurti për një draft -statut të ri edhe pse përbajtjes së propozimit evropian i kishte thënë po. "Kryeministri Kurti pranoi përbajtjen, pranoi fjalët e statutit. Ishte forma rreth së cilës ai kishte shqetësime. Forma duhet të kishte blloqe nënshkrimesh. Kështu që ai pranoi përbajtjen, por kishte

një rezervë për formën, që e kuptoj. Por nuk e kuptoj tani, në qoftë se ju e pranuat përbajtjen, si mund të thoni tani: Oh, dua të bëj një statut tjetër. Këtë nuk e kuptoj", ka thënë Joseph.

Profesori amerikan i është referuar ngjarjes së vitit të kaluar në Bruksel kur krerë të tre shteteve të BE-së - Francës, Gjermanisë e Italisë - kishin zhvilluar takime me Kurtin dhe Vuçiqin.

Joseph thotë se i jep të drejtë

Kurtit për nënshkrimin. "Mendoj se është e arsyeshme që kryeministri Kurti të kërkojë nënshkrim. Për mendimin tim, kjo është plotësisht e arsyeshme. Kemi parë çfarë bëri presidenti Vuçiq, pas gjithë kësaj dhe kështu me radhë, dhe normalisht ju e bëni këtë. Duhet të kujtoni se presidenti Vuçiq nënshkroi marrëveshjen e Uashingtonit megjithëse pak ndryshe, por ai nënshkroi. Dhe kështu mendoj se është në rregull", ka thënë Joseph për RTV21.



Nis puna e përbashkët në mes të MKRS-së dhe British Council në fushën e artit dhe ekonomisë kreative



PRISHTINË, 19 QERSHOR - Rreth një muaj pas nënshkrimit të marrëveshjes në mes të Ministrisë së Kulturës dhe British Council në fushën e artit dhe ekonomisë kreative, puna e përbashkët e tyre ka nisur. "Ministri Çeku ka pritur në takim ambasadorin britanik në Kosovë, Jonathan Hargreaves dhe ekspertin nga Britania e

Madhe për arte dhe ekonomi kreative, John Newbigin, i cili do të jetë i angazhuar në hartimin e strategjisë për industrinë kreative në Kosovë", ka njoftuar MKRS-ja, duke bërë me dije se kontributi i ekspertit britanik do të fokusohet në hartimin e politikave, kërkime dhe avokim në sektorin e ekonomisë kreative dhe ngritjen e

kapaciteteve për profesionistët krijues dhe politikëbërësit, duke siguruar që individët dhe organizatat në fushën e industrisë kreative të rriten. "Vendi ynë nuk ka pasur asnjëherë strategji për zhvillim të industrive kreative dhe jemi të përkushtuar që kjo fushë të marrë vëmendjen e duhur", ka njoftuar MKRS-ja.

Togeri i FSK-së merr çmimin Honor Graduate në ShBA

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Togeri Arbnor Haxhani ka përfunduar me rezultate të larta Kursin Bazik për Oficer të Këmbësorisë (IBOLC) në Georgia të Shteteve të Bashkuara të

Amerikës, duke u shpërblyer me çmimin International Honor Graduate. Gjatë 19 javëve sa zgjati ky kurs, togeri Haxhani ka treguar performancë të lartë, duke e paraqitur

denjësisht Forcën e Sigurisë së Kosovës në mesin e 170 pjesëmarrësve sa ishin në kurs, në mesin e tyre oficerë amerikanë dhe oficerë nga shtete të ndryshme të botës.




Kurti viziton Portin e Hamburgut, sheh Sistemin e Skanimit të Ngarkesave me Rreze X

HAMBURG, 19 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, së bashku me ministrin për Kthim dhe Komunitete, Nenad Rashiq, ndodhet në Hamburg për ta vizituar portin e këtij qyteti, me ftesë të përfaqësuesit të posaçëm të Gjermanisë për Ballkanin Perëndimor, Manuel Sarrazin. Siç ka njoftuar Zyra e Kryeministrit, vizita ka për qëllim shqyrtimin nga afër të Sistemit të Skanimit të

Ngarkesave me Rreze X në portin e Hamburgut. Kjo vizitë është pjesë e punës së vazhdueshme të Qeverisë së Kosovës për ta forcuar sigurinë në kufi për ta parandaluar kontrabandën dhe kërcënimet që vijnë nga jashtë. Një sistem i lëvizshëm skanimit me rreze X ndihmon në monitorimin e kamionëve të mëdhenj që kalojnë kufirin, duke garantuar kështu një nivel më të lartë të sigurisë pa

penguar tregtinë. Gjermania ka shprehur dëshirën për ta mbështetur Kosovën në përmirësimin e sigurisë. Kryeministri bisedoi me përfaqësuesin special të Gjermanisë, Manuel Sarrazin, për kushtet në të cilat qeveria gjermane t'i japë një skaner të tillë. Kryeministri Kurti shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të qeverisë gjermane duke përfshirë fushën e sigurisë.



Bregu: Zero roaming me BE-në deri më 2027

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Perspektiva e Bashkimit Evropian për Ballkanin Perëndimor nuk është më një proces datash. BE-ja po ndryshon, ndoshta duhet të ndryshohet edhe perspektiva drejt detyrave, thotë për Radion Evropa e Lirë, Majlinda Bregu, sekretare e përgjithshme e Këshillit për Bashkëpunim Rajonal.

Bregu ishte sekretare në detyrë, pasi në tre vitet e fundit 13 shtetet anëtare nuk kanë arritur një kompromis për këtë pozitë. Të mërkurën në Shkup, para samitit të kryetarëve të shteteve dhe qeverive, u arrit marrëveshje që sekretar i ri i përgjithshëm të jetë Amer Kapetanoviç.

Radio Evropa e Lirë ka folur me Bregun për punën e saj të mëparshme në krye të Këshillit, projektet e realizuara, problemet e përbashkëta dhe të ngjashme të



vendeve të rajonit.

Për pasardhësin e saj, Amer Kapetanoviç, thotë se e presin sfida

të reja.

Si të arritur të madhe të Këshillit, Bregu e vlerëson edhe uljen e

çmimit të roamingut apo të bisedave telefonike me vendet evropiane, ndërsa beson se deri në vitin 2027 do të ketë zero roaming me BE-në. "Duhet të kihet parasysh se ky nuk është një proces që bëhet me forcë apo me urdhër. Ju nuk mund ta urdhëroni komunitetin e biznesit t'ju ofrojë ulje çmimi për shërbimin që e ofrojnë ata. Edhe marrëveshja që ekziston, si në BE, bazohet në vullnetin e mirë të tyre. Kështu ata vendosën, ne iu afroam të gjithëve, u koordinuam dhe arritëm të kemi një proces të drejtë për të gjithë operatorët e telekomunikacionit, për të 38 pjesëmarrësit në historinë e reduktimit të roamingut, t'i bashkojmë të gjithë dhe t'i informojmë pozitivisht se çmimet për qytetarët e Ballkanit Perëndimor janë tepër të larta dhe të papranueshme. Kështu i ulën

shumë çmimet. Sipas ekspertëve tanë, ata madje i kanë tejkaluar premtimet e tyre. Ata premtuan, në deklaratën e firmosur, se do të nisnin me 30 për qind të shkurtimeve dhe më pas do të vazhdojnë më lart në këtë drejtim. Disa prej tyre shkojnë edhe me më shumë se 50 për qind ulje nga shkurtimet. Disa të tjerë në Bosnjë-Hercegovinë aq më shumë. Pra, më shumë se 80 për qind tani plus paketat verore - janë gjithmonë më të lira se pjesa tjetër e vitit. Pra, presim që ky të jetë një proces hap pas hapi. Dita e roamingut - si në shtëpi, apo roaming me tarifa zero - shpresoj të jetë e mundur deri më 2027. Por, siç thashë, i urej datat. Mund të bëhet më shpejt. Për mua kjo mund të ndodhë që sonte. Por, unë nuk jam operator telekom", ka theksuar Bregu.

Forumi i parë i Biznesit Kosovë - Portugali, Gërvalla fton bizneset portugeze të investojnë në Kosovë

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 19 QERSHOR - Tri memorandume bashkëpunime janë nënshkruar të mërkurën në kuadër të Forumit të Parë të Biznesit Kosovë - Portugali.

Memorandumi i parë ka qenë ndërmjet Odës Ekonomike të Kosovës dhe Asociacionit të Bizneseve të Minho-s, memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Rrjetit Ndërkombëtar të Dhomave të Tregtisë Portugeze (RCCPM) dhe Odës Ekonomike të Kosovës si dhe memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Studimeve Ekzekutive ISCTE dhe Universitetit për Biznes dhe Teknologji (UBT).

Ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, ka thënë se Kosova ka



potencial shumë të mirë për investime në sektorin agro-kulturë. Për këtë ka ftuar bizneset portugeze të vijnë dhe të investojnë në Kosovë. "Ky forum

shënon një arritje historike të marrëdhënieve në mes të Kosovës dhe Portugalisë dhe lidhjeve tona ekonomike dhe kulturore. Të dyja vendet kanë

bërë progres të madh në dy vitet e fundit. Vitet e fundit Kosova ka arritur rritje të madhe ekonomike duke iu falënderuar makro-ekonomisë dhe rritjes së

eksportit. Kjo shënon një arritje historike. Të dyja vendet kanë bërë progres vitet e fundit dhe Kosova tani e ka bërë veten si një partner të besueshëm. Kosova pritet të rritet në sektor të ndryshëm. Sektori i turizmit portugez ofron rritje të madhe në Kosovë dhe ambienti ynë krijon mundësi fantastike për rritje ekonomike në të dy vendet. Agro-kultura është një zonë tjetër premtuese. Kosova ka potencial shumë të mirë për investime në sektorin agro-kulturë", ka thënë Gërvalla, duke shtuar se Portugalia ishte një nga vendet e para që ka njohur shtetin e Kosovës. "Qeveria e Kosovës është e gatshme dhe ka krijuar ambient të favorshëm për investime të jashtme. Kosova gjithmonë do të jetë partnere e besueshme për Portugalinë", ka thënë ajo.

KRU "Prishtina" nis shkyçjet në objektet që kanë borxhe

Prishtinë, 19 qershor - Kompani Rajonale e Ujësjellësit "Prishtina" ka nisur një aksion të ri që fokus ka borxhlinjtë e mëdhenj të shërbimeve të ujit dhe

konsumatorët ilegalë. Aksioni ka filluar në lagjen "Veternik". Për këtë ka folur edhe zëdhënësjja e kësaj kompanie, Arjeta Mjeku, e cila ka thënë se mospagesa e

ujit konsiderohet vepër penale dhe, sipas saj, çdo biznes i cili nuk u përgjigjet obligimeve, do të ndëshkohet. Borxhi ndaj shërbimeve të ujit është mbi

45 milionë euro. Mbi 40 milionë euro janë nga sektori i amvisërisë, kurse mbi 5 milionë nga sektori i bizneseve të vogla dhe të mëdha.



A mund ta ndalim degradimin moral të shoqërisë?

Nga: Gëzim TUSHI

Në shoqërinë tonë ka disa tregues evidentë që janë dëshmi e sigurt e devijimit të sjelljes sociale të njerëzve tanë, që ndikojnë në procesin e akselimit të një lloji degradimi të shoqërisë. Madje, disa komponentë janë bërë shumë shqetësues për funksionimin normal të familjes, shkollës, komunitetit dhe shoqërisë shqiptare në tërësi. Në mënyrë evidente dhe me intensitet të lartë po përballemi me një zgjerim të rritur të amoralitetit, që flet për përkeqësimin e stabilitetit të shoqërisë shqiptare. Nuk është rastësi që tashmë janë rritur tonet e shqetësimit dhe mosbesimit për mënyrën e deformuar të sjelljes, për format asociale të shfaqjes së natyrës së njeriut, që shpesh herë dhe fare gabimisht justifikohen si “dukuri kalimtare”, që do kalojnë me “rrjedhje sociale të lirë”, apo ca më keq kur me mendjelehtësi konsiderohen të natyrshme, duke i vlerësuar si tregues organik të jetës bashkëkohore, si shfaqje të esencës së “njeriut modern”.

Në të vërtetë, po të testosh qëndrimet e vërteta të njerëzve tanë, do të kuptosh menjëherë se të shqetësuar jemi që të gjithë në familje për të sotmen dhe të nesërmen e fëmijëve tanë, për zhvillimet morfologjike dhe problemet që kanë të rinjtë në shkollë, për situatën e martesës dhe problemet që kanë të martuarit, për gjendjen dhe shqetësimet sociale dhe familjare të të moshuarve, për zgjerimin e alkoolizmit, përdorimit të drogës dhe zgjerimin e përmasave të krimit dhe prostitucionit. Duket se ka ardhur koha që të kuptojmë më mirë, me koshiencë qytetare thelbin e asaj që ka ndryshuar apo deformimet që kanë ndodhur në jetën e strukturave sociale të shoqërisë. Duke parë kurbën, drejtimin dhe intensitetin e tyre, mendoj se ato të paktën nuk mund më të nënvlerësohen apo të konsiderohen si dukuri sociale rastësore. Në të vërtetë një mendje normale, një qytetar i shqetësuar për të ardhmen e shoqërisë do të mendonte seriozisht, nga që ato janë thelbësore dhe shqetësuese.

Padyshim, në kohë tranzicioni, ndryshimesh dhe transformimesh radikale të tipologjisë së jetës sonë, është e natyrshme që shumë dukuri që ndeshim të duken të paqarta për t'u kuptuar dhe interpretuar, sepse nganjëherë ato janë të befasishme apo të paparashikueshme në dukje. Por, në të vërtetë tani ne duhet të mendojmë ndryshe dhe të besojmë se ato që po ndodhin në familje, në martesë, në shkollë, në komunitet dhe në shoqërinë shqiptare, nuk janë as të papritura as rastësore. Përkundrazi ato duhen vlerësuar me seriozitet dhe përgjegjësi sociale sepse në thelbin

e tyre janë tregues të ndryshimeve thelbësore që kanë ndodhur në karakterin e shoqërisë shqiptare dhe natyrën e njeriut modern dhe që herë duken sikur janë normale dhe kompatible me kohën, dhe herë të tjera shfaqen në kundërsens me standardet e qytetërimit tonë.

Duhet kuptuar këto ndryshime që kanë ndodhur në tipologjinë e jetës sociale të shoqërisë, në mënyrë që pastaj të kuptojmë dhe pranojmë efektet dhe kundër efektet sociale që kanë ato ndryshime (për mirë apo për keq) që po ndodhin intensivisht tek njeriu dhe shoqëria e ditëve tona. Të cilat janë veçanërisht të thella, kontroversale, eruptive, me frekuenca sociale të pa rregulla. Nuk ka sens që si shoqëri, familje, shkollë apo media të qëndrojmë indiferentë përballë një realiteti moral dhe social që po përkeqësohet dhe degradohet, duke neglizhuar me menefregizëm gati kolektiv (kjo sindromë sociale është bërë patologji e frikshme për shoqërinë tonë) deformimet që shfaqen, ndryshimet regresive jo qytetëruese që po ndodhin në tipologjinë e sjelljes, në tipologjinë dhe natyrën e njerëzve, sidomos të rinjve tanë.

Nuk është mirë për shoqërinë tonë që duket sikur është tulatur e mpirë nga ekspansioni social i “fenomeneve të reja” të jetës, nga komplikimet e natyrshme dhe turbulencat e papërballueshme që po sjell me tepri, në mënyrë fragmentare e të paparashikuar zhvillimet e modernitetit të jetës sociale. Politikanët, intelektualët, prindërit, edukatorët, media dhe shoqëria civile duhet të jenë mendjehapur për të kuptuar atë që po ndodh në shoqërinë tonë, duke vlerësuar koherencën me kohën, ndikimet në formimet dhe deformimet e trajtave të saj. Nuk duhet heshtur kur herë pas here por në mënyrë të “rregullt” dhe sistematike, në shoqëri shtohen njerëzit, veçanërisht të rinjtë që janë bërë protagonistë evidentë të shumë veprimeve amorale dhe sjelljeve brutale e asociale. Janë shtuar rastet e sjelljeve herë me natyrë vandaliste dhe shumë herë të tjera me karakter të qartë kriminal, që në një farë mënyre kanë një peshë të madhe sociale dhe që thelbësisht po dëmtojnë, degradojnë dhe deformojnë kulturën e bashkëjetesës sociale. Shoqërisë tonë po i “shqepen tegelat” social nga që po shtohen njerëzit eksentrikë, asocialë, me deformacione të thella të moralit dhe karakterit.

Përditë dëgjojmë për të rinj që braktisin shkollën, që vanitojnë në rrugë pa plane personale, që bullizojnë, grinden, shpesh edhe e vrasin njëri tjetrin, që përdorin intensivisht drogë dhe alkool dhe duke qënë nën efektin e tyre, humbasin vetëpërbajtjen, kontrollin e vetes, nuk kanë dëshirë të ndjekin shkollën, ose e frekuentojnë atë formalisht, që konfliktohen me mësuesit dhe



pedagogët dhe prindërit e tyre. Po përballemi përditë e më shumë me qytetarë dhe të rinj që janë bërë të dhunshëm në familje, të rebeluar në shkollë, të vrazhdë në ambientet publike dhe shoqëri, që kanë marrë revan seksual dhe nuk duan të dinë dhe të mbajnë përgjegjësi sociale për veprimet e tyre.

Janë disa dukuri që së pari kanë nevojë të njihen, të vlerësohen seriozisht dhe veçanërisht të interpretohen drejt, pa zmadhime artificiale apo zvogëlime subjektive, qoftë nga pikëpamja morale, psikologjike apo sociale dhe sociologjike. Padyshim çrregullimet sociale të njerëzve tanë, sidomos të brezit të ri, për shumë arsye sociale dhe shkaqe moshore, qoftë të natyrës imitative apo të modës, veçanërisht të efekteve të njohura që kanë “imperializmat imponues” të kohës moderne, janë bërë gati “çrregullime sociale” sistematike, të vazhduara, të përgjithshme dhe me karakter kolektiv. Ndaj ne nuk duhet t'i shikojmë dhe vlerësojmë ato si dukuri të shkëputura të jetës së përditshme, apo t'i vlerësojmë si fenomene sociale kalimtare, që me logjikë sociologjike infantile mund të mendohet se ato do të ndodhin nga që kanë “kohën e tyre të lulëzimit”.

Kjo logjikë reduksioniste ka dhënë boll efekte negative, e ka çuar shoqërinë tonë në këtë situatë sociale tejet shqetësuese. Ndaj përkundër qëndrimeve sociologizante simpliste, është koha që seriozisht të mendojmë ndryshe, të fillojmë të përgatitemi në të gjithë institucionet më bazale të organizimit social (familje, shkollë, komunitet, shoqëri civile) se çfarë duhet të bëjmë, cilat janë rrugët që duhen ndjekur në mënyrë që të ndikojmë pozitivisht në dominimin e kulturuar të jetës sociale, në ndryshimin pozitiv të tipologjisë së jetës, në mënyrë dhe stilit të jetuarit të njerëzve, veçanërisht të grupeve të të rinjve, çfarë do bëjmë që ata të rifitojnë motive të shëndosha individuale në mënyrë që të rivendosim parametrat e kohezionit qytetëruës kudo ku ata janë, mësojnë, edukohen apo argëtohen.

Sipas mendimit tim, shumica e problemeve me të cilat përballemi shfaqen në trajtën e “shqetësimeve kulturore” dhe “problemeve edukative”. Por besoj se dukurinë e “degradimit moral” duhet ta shikojmë ca më thellë, duke menduar që të gjejmë shkaqet personale dhe sociale të kësaj shtate. Situata e sjelljeve amorale, veprimeve anarkiste dhe kriminale në sjelljet e shumë

njerëzve është “produkt social” që ka shkaqet e veta ontologjike. Ato lidhen natyrshëm me natyrën e qytetërimit modern, por edhe shumë arsye specifike, që janë të lidhura me të kaluarën tonë historike, defektet kulturore dhe edukative të shoqërisë tonë.

Por, sidoqoftë, në thelb shkak, burimi kryesor i këtyre sjelljeve qëndron në faktin se shoqëria shqiptare ka një kohë të gjatë në tranzicion, që është “periudha e artë” e krizës së vlerave dhe e shfaqjes së dobësisë së institucioneve social-edukative sikurse janë familja, shkolla, shoqëria civile, media dhe institucionet fetare morale. Të cilat realisht kanë një kohë të gjatë që janë në “gjendje nokdauni”, sepse nga pikëpamja morale shoqëria jonë është në gjendje kaotike. Ajo po përballlet me vështirësi serioze për të përcaktuar sistemin e vlerave kulturore, edukative, morale, sociale që duhet të respektohen nga njerëzit tanë, veçanërisht nga të rinjtë.

Në këtë kontekst është koha që jo vetëm të konstatojmë enumeracionin pa fund të sjelljeve jo adekuate me qytetërimin të njerëzve tanë, por na duhet së pari të “hetojmë” shkaqet e kësaj shtate dhe njëherësh, të propozojmë rrugë sociale dhe ndërhyrje individuale për përmirësimin e sjelljes. Sepse qytetarët sidomos të rinjtë, janë bërë aktorë me ndikim social të dukshëm, qytetarë shumë të rëndësishëm, që kanë motivime dhe sjellje individuale dhe kolektive gjithnjë e më komplekse. Në përgjithësi në shoqërinë shqiptare ka disa shfaqje që në kohën tonë janë dukuri universale, që me intensitetin me të cilin shfaqen i kanë tronditur sociologët e shoqërisë moderne dhe psikologët e natyrës së sjelljes së njeriut. Kjo do të thotë që shumë dukuri në jetën tonë sociale, nuk janë dukuri nuk shfaqen vetëm në shoqërinë tonë. Ato tashmë janë dukuri universale, të cilat të vlerësuara globalisht janë material i bollshëm social, për të vërtetuar tezën se në kohën tonë ka një proces që lidhet me shoqërinë dhe njeriun modern, të cilin filozofët e Shkollës së Frankfurit Teodor Adorno dhe Max Horkheimer e kanë quajtur me mençuri si “trënim të natyrës njerëzore që nuk mund të shihet i ndarë prej progresit shoqëror” (M. Horkheimer, T. Adorno, Dialektika e iluminizmit, f. 32).

Unë mendoj se duhet të shqetësohemi nga që jemi duke bërë shumë pak punë në familje, në shkollë, në media dhe në shoqëri, për të ndikuar pozitivisht në përmirësimin e situatës. Është koha që sociologët, psikologët, mësuesit, pedagogët, gazetarët, prindërit tanë, më saktë të gjithë së bashku, duhet të mësohemi të punojmë ndryshe nëse duam rezultate sociale dhe edukative pozitive. Vetëm kështu do mundemi të gjejmë rrugën që të ndalim këtë degradim të

frikshëm të natyrës të njerëzve tanë. Kjo do të thotë që duhet kapur “demi nga brirët”, duhen njohur së pari shkaqet dhe mbi këtë bazë të krijojmë modele të sakta të njohjes dhe interpretimit të shumë dukurive, që vërtetë kanë qenë “të panjohura” më parë në shoqërinë tonë. Pa këtë ndryshim konceptual nuk ka asnjë shpresë se do të kemi ndonjë përmirësim të situatës.

Kjo duhet vlerësuar, sepse deformimet e natyrës së njerëzve tanë nuk janë më probleme sporadike apo ekese të shkëputura individuale. Kjo është shqetësuese sepse deformimet e natyrës së njerëzve tanë kanë tendencë që të bëhen “fenomen kolektiv”, që ka filluar të shfaqet jo vetëm në individë, por edhe në grupe sociale të caktuara. Kjo natyrisht nuk duhet të na ngatërrojë radhën e punës, sepse edukimi i njerëzve tanë veçanërisht i të rinjve është i vështirë. Sidomos në se çështja trajtohet si proces kolektiv, duke mos vlerësuar atë si një proces të rifitimit të motiveve të shëndosha individuale të çdo njeriu për të qenë i aftë të krijojë në shoqëri kohezion social të qytetëruar.

Ndaj koha moderne e ka vënë shoqërinë shqiptare në pozitë të vështirë. Ajo kërkon nga të gjithë aktorët socialë, mediatikë dhe familjarë, që më shumë të merren me parandalimin dhe rregullimin gradualisht të deformimeve që po pëson kultura e njerëzve tanë (që nuk janë vetëm të rinjtë) nga njëra anë, dhe së dyti, të punojmë për të ndihmuar shoqërinë që të kapërcejë situatën shumë të vështirë të mungesës së besimit se gjërat mund të përmirësohen. Pikërisht nga që jeta jonë nganjëherë duket sikur është nën kthetrat e “shoqërisë së rrëmuishme” së cilës i mungon sistemi i vlerave, si kusht për rregullimin e natyrës së njeriut dhe të karakterit të jetës sociale në shoqërinë tonë.

Ky është kusht për të dalluar njerëzit, veprimet antishoqërore, të cilat nëse nuk kemi një “sistem vlerash” morale, kulturore, sociale të njohura të pranuar shoqërisht, është vështirë për “aftësinë parashikuese” të sjelljes së tyre nga shkolla, familja dhe shoqëria. Është i vështirë procesi i formimit dhe edukimit të njerëzve. Por nuk ka rrugë tjetër të frenimit të procesit të “degradimit moral” të shoqërisë, përveç rrugës së ndikimit përmes sistemit të ngulitur të vlerave të sjelljes. Qoftë kur ato vijnë “nga brenda” nga kultura, edukata dhe morali individual i njeriut, apo kur ato “imponohen nga jashtë”, nga mjedisi shoqëror, tradita familjare dhe shoqërore, etj. Natyrisht të gjitha këto bëhen duke e ndërtuar ditë për ditë dhe gradualisht personalitetin dhe natyrën e njerëzve tanë, sidomos të të rinjve. Por, jo me moralizime, për të cilat koha është bërë shumë e vështirë...



Shqipëria shijon pikën e parë në Kampionatin Evropian

HAMBURG, 19 QERSHOR - Shqipëria ka siguruar pikën e parë në "Euro 2024", duke barazuar 2-2 me Kroacinë në kuadër të Grupit B. Ekipi i Sylvinhos dhuroi një super-paraqitje në 45 minutat e parë të ndeshjes, duke gjetur edhe golin e vetëm. Goli i vetëm në këtë pjesë erdhi në minutën e 11-të me anë të Qazim Laçit, i cili shënoi me kokë pas asistimit të Jasir Asanit. Përveç kësaj, Shqipëria pati edhe më shumë raste ideale për gol, duke qenë afër të gjej edhe golin e dytë. Elseid Hysaj (29') goditi mbi portë, ndërsa goditet e Kristjan Asllanit (31') dhe Rey Manajt (45+) u priten nga Dominik



Livaković. Edhe 45 minutat e dytë nisën furishëm, me dy kombëtarët që kishin rastet e

veta, por që kroatët treguan përvojën e tyre. Kroatët e arritën golin e barazimit në minutën e

74-të, kur Ante Budimir asistoi të Andrej Kramariq për rezultatin 1-1. Kroacia nuk u ndal me kaq

dhe përmbysi rezultatin kur në minutën e 76-të Klaus Gjasula ishte i pafat dhe realizoi auto-gol. Shqipëria nuk u dorëzua deri në fund, duke ia dalë që pas shumë tentimeve të realizojnë golin e barazimit. Ishte Gjasula, ai që realizoi për 2-2, kur realizoi në minutën e 90+5-të për 2-2, duke i siguruar Shqipërisë një pikë. Në Grupin B, Spanja dhe Italia kanë nga tri pikë, ndërsa Shqipëria dhe Kroacia me nga një, derisa italianët dhe spanjollët luajnë nesër për të përcaktuar se kush do të jetë lider i grupit. Në ndeshjen e fundit, Shqipëria përballet me Spanjën, duke shpresuar për një fitore.

Trepça në kualifikimet e Ligës së Kampionëve

MITROVICË, 19 QERSHOR - Kampionia e Kosovës, Trepça, do të luajë në kualifikimet e Ligës së Kampionëve në basketboll. Gjithsej janë 24 skuadra që do të garojnë për katër vende, për t'iu bashkuar 28 klubeve që veçse janë kualifikuar për edicionin e ardhshëm. Janë caktuar 28 klube pjesëmarrëse për edicionin e ri të Ligës së Kampionëve në basketboll, si dhe 24 skuadrat, që do të konkurrojnë në turnetë e raundit kualifikues për katër biletat e mbetura për t'i kompletuar skuadrat për edicionin e ri. Sipas rendit alfabetik, 28 skuadrat e kualifikuara janë: AEK Betsson (GRE); BAXI Manresa (SPA); Bertram Derthona Tortona (ITA); Falco Szombathely (HUN); Filou Oostende (BEL); FMP SoccerBet (SER); Galatasaray (TUR); Hapoel Netanel Holon

(IZR); Igokea m:tel (BeH); King Szczecin (POL); Kolossos Rhodes (GRE); La Laguna Tenerife (SPA); Maccabi Ramat Gan (IZR); Manisa Büyükşehir Belediyespor (TUR); Nanterre 92 (FRA); NINERS Chemnitz (GER); Pallacanestro Reggiana (ITA); Peristeri (GRE); Pinar Karsiyaka (TUR); Promitheas Patras (GRE); RASTA Vechta (GJER); Rytas Vilnius (LTU); Basket-Ball Saint-Quentin (FRA); UCAM Murcia (SPA); Unicaja (SPA); VEF Riga (LAT); WKS Slask Wroclaw (POL); Baskets Wurzburg (GJER). 24 klube që do të konkurrojnë në raundin e kualifikimit do të ndahen në katër turne, me fituesin e secilit turne që kalon në sezonin e rregullt. Këto janë 24 skuadrat, sipas rendit alfabetik: Aliaga Petkimspor (TUR); BC Kutaisi 2010 (GJEO); BC Nokia (FIN); Caledonia



Gladiators (BM); Basket Cholet (FRA); CSM CSU Oradea (RUM); Dinamo Banco di Sardegna Sassari (ITA); ERA Nymburk (CEK); Fribourg Olympic (SUI); Heroes den Bosch (NED); Juventus Utena

(LTU); Kalev/Cramo (EST); Keravnos BC (QIP); MoraBanc Andorra (SPA); Norrköping Dolphins (SUE); PAOK mateco (GRE); Patrioti Levice (SLV); Rilski Sportist (BULL); SL Benfica (POR);

Sabah (AZE); Spartak Subotica (SRB); Telenet Giants Antwerp (BEL); Telekom Baskets Bonn (GER); Trepça (KOS). Turnetë e raundit të kualifikimit do të zhvillohen në mes të shtatorit, ndërsa sezoni i rregullt do të fillojë më 1 tetor 2024. Ceremonia e shortit për grupet e sezonit të rregullt dhe turnetë e raundit të kualifikimit do të zhvillohen në Shtëpinë e Basketbollit Patrick Baumann në orën 11:00, më 26 qershor dhe do të transmetohet drejtpërdrejt në kanalën zyrtar BCL YouTube. Për mitrovicasit kjo do të jetë hera e parë që do të luajë në kualifikimet e Ligës së Kampionëve. "Xehetarët" e përfunduan edicionin e kaluar me katër trofe: titullin e kampionit, Kupën, Superkupën dhe Ligën Unike.

Spanjë - Itali, ndeshja kryesore e ditës në 'Euro 2024'

GELSENKIRCHEN, 19 QERSHOR - Kampionati Evropian vazhdon me ndeshjet e radhës në fazën e grupeve edhe sot (enjte). Ndeshja kryesore do të zhvillohet në mbrëmje mes dy kombëtareve të fuqishme që shihen edhe si favorite për ta fituar evropianin, Spanjës dhe Italisë. Këto skuadra përfaqësuese, që janë në grup me Shqipërinë, kanë realizuar

fitore në ndeshjet e para të Grupit B, ku italianët e mposhtën Shqipërinë me rezultat 2-1, kurse Spanja mposhti Italinë (3-0). Cilado kombëtare që realizon fitore do ta sigurojë kualifikimin tuje. Anglia që e nisi Evropianin me fitore në ndeshjen e dytë nga ora 18:00 do të përballet me Danimarkën, e cila barazoi në ndeshjen e parë. Sot në orën 15:00 zhvillohet ndeshja tjetër e

Grupit C mes Sllovenisë dhe Serbisë.

GRUPI B
21:00 Spanja - Italia

GRUPI C
15:00 Sllovenia - Serbia
18:00 Danimarka - Anglia



Useini paraqitet te Llapi

PODUJEVË, 19 QERSHOR - Skuadra e Llapit ka njoftuar se ka arritur marrëveshje për transferimin e mbrojtësit të qendrës, Muhamed Useini. Useini i bashkohet skuadrës së drejtuar nga Tahir Batatina

pas përvojës dyvjeçare me FC Prishtina, me të cilën u paraqit në 72 ndeshje zyrtare dhe arriti t'i realizojë tri gola. Futbollisti tetovar është paraqitur në ambientet e klubit nga drejtori sportiv

Mentor Zhdrella, i cili i ka dëshiruar mirëseardhje dhe i ka uruar suksese të mëtutjeshme. "Useini ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me opsion rinovimi edhe për një vit

tjetër dhe menjëherë është bashkuar me grupin në përgatitjet e garave evropiane. Mirë se vjen dhe paq suksese me fanellën bardhekaltër, Meti", thuhet në njoftimin e Llapit.



Sainz: Mund të firmos që nesër, më kanë kërkuar të gjitha skuadrat e Formulës 1

MADRID, 19 QERSHOR - Ferrari e ka "hequr qafe" pilotin spanjoll Carlos Sainz, që në fund të këtij viti do ta mbyllë kontratën me makinën italiane. Në vendin e tij të njëvendëshja "kokëkuqe" do të ulet Lewis Hamilton, 7 herë kampion i botës në Formula 1. Edhe pse ka disa muaj që

kërkon një ulëse, Sainz ende nuk ka vendosur se ku do të garojë vitin tjetër. Ai ka pranuar se të gjitha ekipet e Formulës 1 e kanë kontaktuar për t'i ofruar një vend edhe pse disa bisedime tashmë janë mbyllur. "Kam disa opsione. Do të vendos shumë shpejt sepse dua ta heq

mendjen dhe të përqendrohem në pjesën tjetër të kampionatit me Ferrarin. Këtë vit kam makinën për të fituar garat dhe për t'u ngjitur në podium, kështu që dua të fokusohem në të tashmen", ka thënë Sainz. "Më pas do të ketë kohë për të menduar për

vitin 2025. Williams? Siç u përmend, kam disa opsione, praktikisht jam në listën e çdo ekipi që ka ende një vend të hapur për vitin e ardhshëm. Mund të nënshkruaj që nesër, por nuk do ta bëj sepse dua ta bëj më të lehtë. Dhe Williamsi mund të jetë një opsion për mua", ka deklaruar spanjollin.



Messi: Argjentina është favorite në Kupën e Amerikës

BUENOS AIRES, 19 QERSHOR - Lionel Messi, kapiteni i kombëtares së Argjentinës, po përgatitet të përjetojë një tjetër Kupë të Amerikës. Skuadra e Scaloni, kampione në fuqi e botës, është padyshim favorite: "Gjithmonë kam thënë dhe përsëris se Argjentina është favorite. Ne jemi gjithmonë më të mirët, por nuk duhet t'i marrim gjërat si të mirëqena: kështu kemi pësuar kaq shumë zhgënjime në të kaluarën. "Sot mund të themi se jemi më të mirët sepse jemi kampionët në fuqi të botës, por kjo nuk do të thotë se do ta fitojmë këtë Kupë të Amerikës duke ecur", ka deklaruar Leo në një intervistë në "America TV" me gazetarin dhe ish-presidentin e San Lorenzo, Marcelo Tinelli.

Messi nënvizoi se Ekuadori "ka një brez të rinjsh shumë të mirë, të cilët dinë çfarë duan dhe janë intensivë" dhe përfshiu Kolumbinë, Uruguain dhe Brazilin në grupin e favoritëve. "Kjo është arsyeja pse unë them se



do të jetë një Kupë e Amerikës shumë, shumë e luftuar. Grupi e di këtë dhe është i vetëdijshëm se ne do të duhet të japim më të mirën tonë dhe ende më shumë për të fituar përsëri".

Kapiteni argjentinas nënvizoi atmosferën e mirë në dhomat e zhveshjes së Albiceleste: "Pasi kemi fituar kaq shumë vitet e fundit, kemi një qetësi më të madhe shpirtërore". Më pas për triumfin në Katar: "Kam qenë gjithmonë

mirënjohës për dashurinë që kam marrë gjatë karrierës sime, sikur të gjithë donin të përfundonte kështu, se unë nuk mund ta lija futbollin pa qenë kampion bote. "Dhe falë Zotit ishte e mundur, ishte një hakmarrje për humbje më 2014. Unë i plotësova të gjitha ëndrrat e mia dhe arrita më shumë. Nuk e kisha imagjinuar kurrë se do ta përjetoja të gjithë këtë. Mendoj se gjithçka ndodh për një arsyeje dhe se gjithçka është e shkruar".

Mercedesi zgjedh Antonellin në vend të Hamiltonit

SHTUTTGART, 19 QERSHOR - Mungon vetëm zyrtarizimi, por piloti i dytë i Mercedesit për vitin 2025 do të jetë 17-vjeçari italian Kimi Antonelli. Ai do ta zërë vendin e 7 herë kampionit të botës Lewis Hamilton, që ka firmosur për Ferrarin. Antonelli garon për markën Mercedes që kur ishte 11-vjeçar, në kategorinë 60 MiniKart. Në atë kohë, Kimi Antonelli ishte një emër pothuajse i panjohur. Ishte Toto Wolff ai që zbuloi dhe vendosi ta mbështeste karrierën e këtij italiani shumë të ri, duke menduar pikërisht për ditën kur Lewis Hamiltoni do të largohej Formula 1. Gjërat shkuan pak më ndryshe, sepse Lewisi do të vazhdojë të garojë, por për "kokëkuqen". Megjithatë, gjysma tjetër e "profecisë" së Wolff është në prag të realizimit. Në vitin 2025 do të jetë Antonelli ai që do të garojë për makinën gjermane. Ai që do ta marrë trashëgiminë e Hamiltonit dhe do të jetë shoku i ri



i skuadrës së George Russellit. Madje debutimi mund të ndodhë që këtë sezon me makinën Williams, në gjysmën e dytë të vitit. I pari që kuptoi se Antonelli kishte diçka të veçantë ishin zbuluesi i talenteve Giovanni Minardi. Edhe pse Antonelli veshi fillimisht ngjyrat e Tony Kart, pranë Akademisë Ferrari, makina nga Maranello nuk lëvizte me një ofertë, ndaj ai u transferua në Energy, ku u vu re nga Wolff. Fati i

Kimit ka marrë drejtimin e Mercedesit që në vitin 2018. Pjesa tjetër është histori. Duket sikur po rishikojmë rrugën e Hamiltonit, i cili në moshën 13-vjeçare u nënshkrua nga McLaren-Mercedes i Ron Dennis. Për më tepër, Antonelli eci përpara, si Verstappen, duke u rritur nën krahun mbrojtës të babait të tij Marco, ish-pilot për Peugeot, BMW dhe Alfa Romeo në Superturismo.

SHKURT

Mbappe humbet dy ndeshjet e grupit: Shijojeni këtë kompeticion dhe luani pa frikë

Kylian Mbappe do të mungojë në të dyja sfidat e grupit, në të cilat Franca do të përballlet me Holandën dhe Poloninë. Shkak u bë lëndimi në hundë i yllit francez dhe ndërhyrja që do të kryejë. Të gjithë shpresojnë ta kenë gati Mbappen, në ndeshjet e raundit të 1/8 të finaleve. Vetë Mbappe nuk ngurron t'i motivojë shokët e skuadrës në prag të sfidës me Holandën. "Kënaquni djema, shijojeni këtë kompeticion. Nuk duhet të kemi frikë nga asgjë dhe nëse e bëjmë këtë gjë, do të bëjmë shumë mirë në vazhdim", përfundoi Kylian Mbappe.

Ronaldo dhe Pepe në histori, rekordet e dysjes luzitane

Cristiano Ronaldo dhe Pepe janë dy prej lojtarëve që te Portugalia mund të konsiderohen nga më të rëndësishmit e skuadrës. Të dy së bashku japin prej më shumë vitesh kontribut të jashtëzakonshëm për luzitanët. Edhe në mbrëmjen e së martës, të dy ishin në fushë përballë Çekisë, duke shënuar emrin e tyre në listën e rekordeve. CR7 luajti Evropianin e tij të gjashtë, teksa nga viti 2004 nuk ka munguar në asnjë turne kontinental. Askush më parë nuk ka arritur të marrë pjesë në kaq shumë evropianë, duke vendosur një rekord unik. Ronaldo arriti që më 2016 ta fitonte trofeun, e në Evropianin e tij të fundit të përsërisë të njëjtin sukses. Në krahun tjetër, Pepe zbriti në fushë ndaj Çekisë në moshën 41-vjeçare 113 ditë. Kështu, mbrojtësi bëhet futbollisti me moshën më të madhe që luan në finalen e një Evropiani. Ndonëse me më shumë se katër dekada, Pepe luajti për 90 minuta, duke e ndihmuar jo pak skuadrën e tij.

PSG-ja, gati 130 milionë euro për Osimhenin

Largimi i Kylian Mbappes ka lënë një boshllëk dhe Paris Saint Germaini po do ta zëvendësojë sa më shpejt. Ylli francez u largua nga parisienët si një futbollist i lirë për të kaluar te Real Madridi, ndërkohë PSG po kërkon një zëvendësues të denjë për Mbappen. Objektivi kryesor i tyre është transferimi i Victor Osimhen, edhe pse asnjëherë nuk është e lehtë të transferosh një lojtar nga Napoli. Me një klauzolë përfundimi të përcaktuar në 130 milionë euro, Osimhen bëhet një nga objektivat më të shtrenjtë dhe më të lakmuar në tregun aktual. PSG-ja, e ndërgjegjshme për konkurrencën dhe sfidën financiare që përfaqëson ky operacion, është e gatshme të vendosë në tavolinë shumën e nevojshme për ta transferuar nigerianin në "Parc des Princes". "Le10Sport" ka raportuar se parisienët tanimë janë në bisedime të avancuara me Napolin dhe duan me çdo kusht rikthimin e Osimhen në Ligën 1, ku nigeriani më parë kishte shkëlqyer me fanellën e Lilles. Përveç PSG-së, në garë për Osimhen mbeten edhe dy top skuadrat angleze Chelsea dhe Arsenal.

Martinez: Treguam karakter, të vazhdojmë kështu

Portugalia fitoi vetëm në sekondat e fundit të lojës, kur një gol i Francisco Coincencao, në shtesë i dhuroi tri pikët e

para kombëtares portugeze. I kënaqur u shfaq me këtë fitore tekniku spanjoll Roberto Martinez. "Ishte një provë

karakter. Kontrolluam 70 % të topit, goditëm 13 goditje nga këndi. Karakteri i treguar sot ishte i pabesueshëm. Do të na

ndihmojë shumë në të ardhmen. U mbrojtëm shumë mirë, aq sa i lejuam një skuadre si Çekia të na godiste

vetëm një herë drejt portës, sinjal ky që po të vazhdojmë kështu jemi në rrugën e duhur", ka thënë Martinez.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

